



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XIX-të (nëntëmbëdhjetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 06 mars 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e Komunës, dhe filloi në orën 10:05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkollli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE, Attila Csemi dhe Jama's Pap, përfaqësues të KFOR-it - (lista e pjesëmarrësve)

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj punë të mbarë, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë të gjithë, andaj në vazhdim po i lexoj pikat e rendit të ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njzëri me 8 vota Për, nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbal nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 02.02.2024.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njzëri, me 9 vota Për, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 09 janar 2024.

2. Informatë e Shefit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, pas takimit me Drejtorin e Kompanisë Regjionale të Mbeturinave “Pastrimi” lidhur me vazhdimin e kontratave të punës për 14 punëtorët e kësaj Kompanie, 9 prej të cilëve janë nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, e paraqiti Informatën në fjalë, theksoi, në mbledhjen e kaluar të Komitetit u shtrua edhe kjo temë, normale që kanë qenë të punësuar me kontratë 14 punonjës në Kompaninë “Pastrimi” me kohëzgjatje 6 muaj me mundësi vazhdimi edhe për 6 muaj të tjerë, dhe duke u bazuar në atë që punësimi është çështja më e rënduar e në veçanti të komunitetet jo shumicë ku në të gjitha institucionet komunale të Komunës së Podujevës janë vetëm 36 punëtorë nga komuniteti jo shumicë e që prej tyre 27 janë të punësuar të rregullt kurse 9 persona janë të punësuar me kontrata të vazhdimit nëse mund ta quaj kështu.

Unë kam insistuar të takohem me drejtorin e Kompanisë “Pastrimi”, pastrimi konsideroj se është në nivel të mirë në Komunën e Podujevës dhe ka nevojë për punëtor sepse në këtë kompani janë 55 punëtor prej tyre 5 janë nga komuniteti jo shumicë me kontratë të përgjithshme, mirëpo pas një insistimi të madh duke marrë parasysh territorin e madh të Komunës tonë ku Kompania bënë grumbullimin e mbeturinave është dashur të kërkohet shtimi i numrit të punëtorëve dhe në këtë aspekt janë punësuar edhe 14 punëtor ku prej tyre 9 janë nga komunitetet jo shumicë me kontratë 6 muaj plus 6 muaj, mirëpo pasi i’u është skaduar kontrata, me insistimin e Kryetarit të Komunës dhe pas takimit me Kryeshefin e Kompanisë “Pastrimi” kanë ardhur deri te nënshkrimi i një Memorandumi sipas të cilit është vazhduar kohëzgjatja edhe për 6 muaj e punësimit të atyre punëtorëve, dhe atë nga data 01 shkurt të këtij viti deri më 31.01.2025. do të thotë është një kontratë 1 vjeçare për ata 14 punëtor ku 9 prej tyre janë nga komunitetet jo shumicë dhe ajo që është e rëndësishme në këtë Marrëveshje ka të bëjë me pagesën e atyre punëtorëve ku 50% i paguan Kompania “Pastrimi” dhe 50% Komuna.

Pra e përgëzojmë këtë Marrëveshje dhe tani në Kompaninë “Pastrimi” kemi 14 punëtorë që janë nga radhët e komunitetit jo shumicë për çka mendoj se është gjë e mirë edhe për Komunën edhe për qytetarët për një jetë dhe një mirëqenie më të mirë, pra kemi të bëjmë me një respekt prej Komunës dhe prej Kompanisë “Pastrimi”.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin z.Liman Zeqiri për informata e dhëna. Vërtetë ishte një shqetësim i madh i atyre punëtorëve që fillimisht nuk i’u vazhduar kontrata e punës e me të cilët kemi pas disa takime sepse kërkonin takime me mua si kryesues i komitetit dhe me z.Liman Zeqirin si shef i ZKKK, e që i mirë besoj se ta humbësh një vend pune sot nga e cila thuajse po varet një familje, prandaj ne e ngritëm këtë çështje në mbledhjen e kaluar dhe falë Zotit u realizua kërkesa e tyre për çka i falënderoj Kryetarin e Komunës, pastaj shefin e ZKKK dhe drejtorin e Kompanisë “Pastrimi” sepse kemi vazhdimin e atyre 9 punëtorëve e që realisht bëhet fjalë për 9 familje, madje për 1 vit të tërë, e pastaj të shohim si po rrjedhin gjërat.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e konsideroj të përfunduar, dhe vazhdojmë me pikat e radhës.

3. Raporti i punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për vitin 2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, Raporti në fjalë tani na u shpërnda edhe në formë fizike nga shefi i ZKKK dhe qenka bukur voluminoz, mirëpo sigurisht që edhe tani do ta paraqes në pika të shkurtra këtë raport.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, paraqiti Raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, Raporti për të cilin po diskutojmë sot është i publikuar edhe në ueb faqen e Komunës dhe nga ky fakt kam konsideruar se të gjithë të interesuarit kanë mund ta shkarkojnë dhe ta kenë, mirëpo e pash të arsyeshme që tani t’jua bëjë nga një kopje fizike dhe t’jua jap në këtë mbledhje që ta keni të gjithë anëtarët e këtij Komiteti.

Raporti është paksa voluminoz e që ndoshta është dashur të reduktohej, mirëpo duke marrë për bazë që unë gjithherë e them të vërtetën rreth kësaj fushe, mirëpo nuk mund t’i ikim faktit që ne si Zyre Komunale për Komunitete dhe Kthim, Njësi për të Drejtat e Njeriut, zyrtarja për barazi gjinore, zyrtari për të drejtat e fëmijëve, që jemi në kuadër të kabinetit të Kryetarit, paraqesim raporte javore për të gjitha aktivitetet në bazë të punës, volumit dhe plan programit të punës që kemi e që normale që ne punojmë edhe në terren përveç aktiviteteve në zyrë dhe takimeve që kemi, e që shumë nga temat që shtrohen janë edhe temat që shtrohen në mbledhje të Komitetit.

ZKKK ka një koordinim jashtëzakonisht të mirë me të gjitha Drejtoritë komunale si dhe normalisht meqë jemi në kuadër të Kabinetit të kryetarit kemi koordinim dhe bashkëpunim të mirë edhe me Kryetarin e Komunës dhe të gjitha dikasteret që merren sidomos me integrimin dhe lartësimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë në të gjitha sferat e jetës, qoftë në arsim, punësim, shëndetësi, inspeksion, infrastrukturë, urbanizëm, bujqësi, kulturë, media dhe të gjitha të tjerat dhe atë me një respekt dhe intensitet të mirë ku për çdo ditë jemi në kontakt e që në bazë të kontakteve normale që hartohen edhe raportet, mirëpo duke analizuar atë që kemi të bëjmë me një Raport pune, ne kemi një koordinim jashtëzakonisht të mirë edhe me institucione nacionale, pra Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke i nisur nga Zyra për Komunitete dhe Kthim pran Zyrës së Kryeministrit, pastaj edhe me Ministrinë e linjave që kemi dhe mbajmë takime të rregullta sipas orarit të tyre që kemi siç është Ministria për Komunitete dhe Kthim, pastaj kemi Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Punëve të Brendshme, por edhe me të gjitha Ministrinë tjera që janë me interes për avancimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë. Hartimi i shumë Planeve që është bërë në Komunën e Podujevës, është në kuadër të Strategjive të ndryshme, siç është Strategjia për avancimin e të drejtave të komuniteteve RAE 2022-2026, Strategjia nacionale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre 2023-2027, pastaj Strategjia nacionale për migrim që është në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme në bashkëpunim edhe me Komunitat, Strategji këto të cilat janë të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe në bazë të këtyre Strategjive janë të hartuara edhe Planet e veprimt, andaj çdo Komunë duke marrë për bazë këto Strategji duhet të hartoj edhe Planet e veprimt e që normale se secila Komunë ka edhe specifikat e veta.

Unë bashkërisht edhe me Njësin për të Drejtat e Njeriut, zyrtaren për barazi gjinore, zyrtarin për të drejtat e fëmijëve, po ashtu kemi në kandër të Komunës edhe Komitetin Komunal Veprues në të cilin janë dy anëtar nga radhët e Komitetit jo shumicë të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë apo që janë në kandër të OJQ-ve përkatëse (z.Xhafer Ademi dhe z.Bekim Sejdiu), dhe bashkërisht kemi ardh deri te hartimi i Planeve dhe dokumenteve të cilat janë të një rëndësie të veçantë, madje edhe duke u përfshirë edhe në Raportin e Progresit dhe në plane dhe dokumente të ndryshme Evropiane, prandaj jo për modesti por ne radhitemi në mesin e Komunave më efikase sa i përket hartimit dhe miratimit të Planave, e që në bazë të takimeve që kemi pas me

DEMOS, me Zyrën e Kryeministrit, me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Punëve të Brendshme, pra Komuna jonë është radhitur si më e mira në hartimin e planeve, raporteve dhe planeve të veprimit, për çka falënderoj shumë OSBE-në e cila çdo herë na ka mbështet dhe me të cilën kemi një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë si Komunë e Podujevës gjithëherë duke pas bashkëpunim dhe konsulta produktive por edhe mbështetje qoftë kuptimin e materialeve qoftë në kuptimin e komunikimit dhe në shumë çështje tjera të nevojshme, dhe në bazë të kësaj me insistimin e OSBE-së kemi qenë edhe në një trajnim ku unë isha i deleguar nga Komuna e Podujevës në Komunën e Ferizajt për t'iu treguar se si hartohen Planet e tilla komunale.

Krahas Planit lokal të veprimit për avancimin e të drejtave të Komuniteteve RAE për periudhën 2023-2026, Komuna e Podujevës ka hartuar edhe Planin lokal për riatdhesimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025, pastaj kemi hartuar Planin lokal të veprimit kundër dhunës në familje 2023-2026, mandej Planin lokal të veprimit për barazi dhe mos diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026.

Duke u bazuar në këto plane ne i kemi marrë për bazë disa sektor jashtëzakonisht të rëndësishëm si dhe duke u koordinuar me Drejtoritë përkatëse dhe t'ju them të drejtën në këtë Raport figuron edhe vizita që kam bërë në çdo familje të komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Komunën e Podujevës së bashku me Njësitin për të drejtat e njeriut dhe Kryesuesin e Komitetit për Komunitete, pra në të gjitha Lagjet ku jetojnë Komunitetit jo shumicë (Orllan, Batllav, lagja në rr."Ali Ajeti", Lagja në rr."Xhafer Ademi" në qytet) si dhe në të gjitha shkollat ku vijnë shkollimin nxënës të komuniteteve jo shumicë, e që vërtetë ju them se statistikat janë të sakta.

Nga ajo që kemi marrë në terren dhe kërkesat e tyre ke ardh deri te ky Raport dhe figurojnë të gjitha çështjet e tyre në të gjithë sektorët dhe fushat përkatëse.

Në Komunën e Podujevës shumica e komuniteteve jo shumicë janë Ashkalinj dhe për këtë mund t'i gjeni të gjitha të dhënat në Raport, pra në Komunën e Podujevës janë 152 shtëpi të komuniteteve Ashkalinj me 887 banorë, pastaj komuniteti Rom ka 9 shtëpi me 67 banorë si dhe komuniteti Egjiptas ka 2 shtëpi me 12 banorë, pra gjithsejtë kemi 163 shtëpi dhe 966 banorë të komuniteteve jo shumicë që janë në Komunën e Podujevës.

Këto komunitete ne jemi në dijeni dhe në bazë të raporteve, kanë nevojë për shumë çështje dhe ajo që është më e rëndësishmja që mund ta quaj ashtu është punësimi dhe normale që përveç punësimit dihen rrethanat që ne jetojmë dhe po ashtu normale që ne kemi edhe rekomandime të komuniteteve jo shumicë por edhe të qytetarëve në përgjithësi sa i përket tregut të lirë dhe anës profesionale ngase ndoshta institucionet janë të stërngarkuara e që nganjëherë është edhe mundësia e punësimit në tregun e lirë apo thënë ndryshe në sektorin provat në shumë kompani që kërkojnë punëtor dhe në këtë aspekt ju them një statistikë ku shumë kompani që kërkojnë punëtorë dhe që ofrojnë kontrata pune të cilat i paraqesin edhe përmes rrjeteve sociale dhe mediave, kemi 3000 punëtorë të cilët kanë ardhur nga shtetet e huaja dhe janë të punësuar në Kosovë e që shumica prej tyre janë nga Turqia dhe nga Bangladeshi, dhe tani kur e analizojmë këtë atëherë është mirë të kërkojmë punë dhe të jepet një mundësi ku shumë kompani janë të interesuara për punëtor dhe ata që kërkojnë mund edhe të gjejnë.

Ajo që është më shqetësuese tek komunitetet e që në bazë të vizitave kemi arrite të nxjerrim, janë shumë familje që kanë nevojë për ndërtim dhe çështja kryesore e strehimit dhe banimit është çështja pronësore. Në bazë të thirrjes që ka qenë në vitin e kaluar dy thirrje publike nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, për renovimin, rindërtimin dhe për sanitari për komunitetet jo shumicë, ne si ZKKK në bashkëpunim me sektorin e strehimit i'u kemi ndihmuar në rregullimin e dokumentacioneve për aplikim, mirëpo

unë kam pas kontakte edhe në Ministrinë përkatëse rreth një kriteri që ka qenë në formular e që paksa është problematike sigurimi i pronave për ndërtimin e shtëpive, sanimin dhe renovimin e shtëpive të komuniteteve e që ky problem mund të na përcjellë edhe neve si komunitet shumicë sepse një pjesë e madhe nuk kemi prona në emrin tonë, prandaj unë kam kërkuar që nëse është e mundur të thjeshtëzohet ai kriter në mënyrë që të mund të kenë pronën edhe në emër të gjyshërve, babës, axhës e të tjerë familjarë me atë mbiemër në mënyrë që të kenë mundësi dhe të verifikohet dokumentacioni dhe të jenë përfitues.

Për renovim të shtëpive kanë qenë 46 kërkesa në nevojë, pastaj janë 6 familje me kërkesa për ndërtimin e shtëpisë si dhe kanë qenë 2 familje të cilat kanë pasë nevojë dhe kërkesë për mbindërtim në bazë të marrëveshjeve mes vëllezërve, mandej ka edhe 32 familje të cilat kanë paraqitur kërkesa dhe që kanë nevojë për sanitari në bazë të konkursit / thirrjes së hapur publike për financimin e kërkesave / projekteve të komuniteteve jo shumicë.

Duke u nisë nga këto parime, në asistencë sociale dhe faktorë tjerë është një numër i madhe i familjeve ku 66 familje me 353 anëtarë të komunitetit Ashakilnj dhe janë 5 familje të komunitetit Rom me 37 anëtarë e që gjithsejtë prej këtyre komuniteteve në asistencë sociale janë 390 anëtar.

Në vizitat nëpër të gjitha shkollat që kemi bërë, dhe unë në cilësinë e anëtarit të Komisionit për parandalimin e nxënësve në bashkëpunim me Kryesuesin e Komitetit dhe me Drejtorinë e Arsimit nga e cila është koordinatori z.Blerim Vllasa, kemi shkuar në të gjitha shkollat dhe kemi vizituar të gjithë nxënësit e shkollave nga të cilët kemi marrë informacione dhe në bazë të kësaj kemi intervenuar tek Drejtori i shkollës përkatëse, te mekanizmi për parandalimin e nxënësve në kuadër të shkollave si dhe normale tek Komisioni përkatës në kuadër të DKA-së që është mekanizëm i veçantë për përcjelljen e nxënësve nëpër shkollat e mesme dhe fillore në Komunën e Podujevës, pra nga Klasa 3 I-rë deri në klasën e IX-të.

Në shkollat e mesme kuptohet se është e drejtë e secilit të shkojnë apo jo dhe ne kemi insistuar t'iu ndihmojmë atyre nxënësve të komuniteteve jo shumicë që të regjistrohen me mjete dhe mundësi që ka Komuna në mënyrë që të jetë një numër sa më i kënaqshëm i regjistrimit të nxënësve të komunitetit jo shumicë, në Shkollën “Naim Frashëri” janë 78 nxënës të komuniteteve jo shumicë ku prej tyre 35 janë vajza kurse 43 janë djem, pastaj në shkollën “Shaban Shala” janë 8 nxënës, nga 4 prej dy gjinive, pastaj në Shkollën “DR Ibrahim Rugova” janë 78 nxënës prej tyre 36 vajza dhe 36 djem, në Shkollën “Zahir Pajaziti” në fshatin Orllan janë 8 nxënës prej tyre 5 vajza dhe 3 djem, në Shkollën “Luigj Gurakuqi” në fshatin Batllav janë 8 nxënës prej tyre 2 vajza dhe 6 djem, pastaj në Shkollën “Ali Ajeti” në fshatin Sfeçël janë 5 nxënës prej tyre 3 vajza dhe 2 djem, në Shkollën “Isa Boletini” janë 14 nxënës prej tyre 10 vajza dhe 4 djem, në Shkollën “Fan S.Noli” janë 2 nxënës djem, pra gjithsejtë në shkollat e Komunës së Podujevës kemi 179 nxënës, 10 prej tyre në sistemin parashkollor, 16 në SHML.

Pastaj në Kolegje dhe Universitete po ashtu ka ngecje sa i përket vijimit të studentëve, por në të ardhmen është mirë të stimulohen nxënësit e komuniteteve jo shumicë që të vazhdojnë shkollimin universitar. Çka është interesante se në Shkollën “Isa Boletini” kemi nxënësit ndër më të mirët nga komunitetet jo shumicë dhe me nota shumë të larta e që vazhdojnë studimet dhe normale që në bazë të studimeve pastaj edhe arrijnë deri tek një vend i punës.

Unë mund t'ju jap sqarime edhe në fushat tjera mirëpo e pash të arsyeshme të fokusohem vetëm në pikat më të ndjeshme që janë tek komunitetet jo shumicë që kanë nevojë më shumë siç është punësimi, strehimi, banimi, pastaj shkollimi, shëndetësia, shërbimet publike, drejtoria e bujqësisë, urbanizmi që janë për të gjithë qytetarët dhe mendoj se do të realizohen të gjitha projektet dhe nuk ka kurrfarë dallimesh, përveç disa çështjeve të cilat i specifikove si theks i veçantë që ndoshta janë më të rëndësishme për neve.

Të jemi më shumë të sinqertë, unë mendoj se ndoshta na duhet edhe më shumë të punojmë, nuk mund të them se e kam dhënë kontributin që është dashur të jap, mirëpo me angazhimet tona qoftë komunale qoftë të institucioneve qendrore ne do të jemi në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallim etnie dhe çdo herë në shërbim sepse është edhe obligim i joni dhe detyrë për çka ne edhe paguhemi.

ZKKK është e gatshme çdo herë për çdo person të komuniteteve ashtu siç i'u kemi ndihmuar gjithëherë në shumë dokumentacione të fushave të ndryshme, por do të vazhdojmë të jemi shumë të hapur dhe në shërbim të komuniteteve për një jetë dhe një gjendje më të mirë për të gjithë qytetarët, me theks edhe për komunitetet jo shumicë.

znj.Fikmete Qurkolli, theksoi, sa i përket punësimit mund të them se në vazhdimësi po ka të punësuar djem, andaj konsideroj se është duke u bërë shkelje nda të drejtave të femrës.

Asnjë femër e komunitetit jo shumicë nuk jemi të punësuar në institucione askund.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, parafolësja ka të drejtë në atë që e potencoj për çka e falënderoj dhe kam shumë respekt, mirëpo ne duhet t'i sqarojmë disa gjëra të cilat janë decizive sepse ne nuk kemi kompetencë dhe fuqi për të punësuar njerëz, por ne jemi ata të cilat janë informata dhe mendoj se ka nevojë shumë sidomos gjinia femërore për punësim dhe plotësisht pajtohem me parafolësen, mirëpo për projekte të ndryshme të Komunës që duhet të konkurrohet siç ishte ky i fundit për pajisje të ndryshme të rrobaqepësisë etj etj të ngjashme, pastaj kemi bashkëpunim edhe me organizatën IOM që sidomos gjinia femërore mund të ketë përparësi mirëpo nuk po konkurrojnë. Është mirë të konkurrojnë gjinia femërore në projekte që janë të rëndësishme e që pastaj varet nga projekti dhe mund të vihet deri te vetëpunësimi përveç asaj anës institucionale që e paraqiti edhe parafolësja në konkurse të hapura e që është mirë të ngritët kuota gjinore në punësim sepse kriteret janë të barabarta.

Ne duhet të bëjmë një promovim për avancimin e të drejtave të komuniteteve që kushtimisht e them se kanë një poentim pak më të lartë në mënyrë që të vihet deri te një vend i punës.

Në këtë aspekt falënderoj shumë edhe BE-në dhe Organizatën IOM për mbështetje të vazhdueshme dhe që ceket edhe në raportin përkatës se të gjitha shkollat ku ka nxënës të komuniteteve jo shumicë sot janë të pajisura me të gjitha kabinetet dhe më moderne do të thoja që përfitojnë nga BE, mirëpo ka edhe shumë familje që përfitojnë nga këto fonde të BE-së siç është rasti i fundit javën e kaluar ku isha edhe unë prezent tek një familje e cila edhe në të kaluarën ka përfituar mbi 4500 €, fjala është për z.Rexhep Turreci nga Sfeçla, dhe tani ishte përfitues edhe me dy mjete pune sepse ai është me një punë të suksesshme dhe efikase për dallim nga disa që kemi raste sepse kanë përfituar mjete pune por nuk i kanë futë në funksion dhe nuk i kanë shfrytëzuar e që nganjëherë edhe ne po vihemi në situata të palakmueshme kur po vijnë në vizita për të kontrolluar subvencionet e tyre e që normale se ato janë ndihma që jepen në emër të vetëpunësimit dhe asistimit për komunitetet jo shumicë përmes formave të ndryshme në sektorin privat sepse në sektorin publik po është paksa më problematike.

Enti i punësimit apo Zyra e punësimit është një zyrë e veçantë për mundësi punësimi mirëpo që shumë pak ka të tillë që shkojnë lajmërohen e që unë mendoj se është mirë të lajmëroheni për punësim sepse aty pastaj figuron emri dhe ka më shumë mundësi me ardh deri te punësimi.

Pra unë plotësisht pajtoj me parafolësen e cila ka shumë të drejtë në atë që e ceku që numri i të punësuarave femra nga komunitetet jo shumicë është shumë i vogël / minimal, çështje e cila është shumë e rëndësishme dhe kërkon të ngritët edhe në nivelet më të larta.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, çështja e ngritur rreth punësimit të femrave të komuniteteve jo shumicë, vërtetë kemi një numër të madh të femrave në komunitetin jo shumicë që kanë kryer shkollimin e mesëm dhe që nuk janë të punësuara dhe sipas statistikave që kam unë asnjë femër nuk e kemi të punësuar në sektorin publik komunal.

Po ashtu jam i informuar se një numër i tyre kanë kërkuar punësim tek kompanitë private por nuk kanë mundur të gjejnë vende pune, kështu që në sektorin publik nuk jam në dijeni se a i kanë përcjellë konkurset dhe a kanë aplikuar, mirëpo do të ishte mirë dhe thërras të përcjellën dhe të konkurrojnë në mënyrë që të arrijnë deri tek një vend pune si dhe në mënyrë që të na krijohen edhe neve mundësi si Komitet për Komunitete të ngrisim pastaj si çështje, prandaj mendoj se mundësitë janë minimale sepse nuk ka.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth Raportit të ZKKK sepse tema është ky Raport edhe pse paska u shtrua një çështje paraprakisht që u diskutua, Raport i cili konsidero se është mjaftë i mirë dhe janë gjëra të cilat vërtetë janë kryer në Komunën e Podujevë.

Sa i përket ndihmesës nga ana ZKKK dhe konkretisht z.Liman Zeqirit për peronat e komuniteteve jo shumicë sa i përket dokumentacioneve si dhe nevojave tjera të ndryshme që kërkojnë pjesëtarët e Komuniteteve jo shumicë nëse unë apo ndokush tjetër nuk ka mundësi t'i ndihmoj palëve vetëm i orientoj te shef i ZKKK z.Liman Zeqiri i cili n asnjë rast nuk më ka ndodh që nuk ka kryer punë e që ka qenë e mundshme të kryhet edhe pse në disa raste ndoshta nuk e kemi pasë si detyrë. Prandaj e përgëzoj z.Liman Zeqirin për këtë Raport të sjellë në këtë mbledhje të cilin sigurisht se do t lexojmë dhe analizojmë dhe në mbledhjen e radhës mund të dalim me ndonjë koment.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, në raportin e ZKKK më shumë ka shqetësime e konkretisht shqetësime që unë i kam cekë dhe që kryesisht lidhen me avancimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë në të gjitha fushat e jetës, këto gjëra mua më provokojnë në një mënyrë dhe provokimi tek unë pastaj e konsideroj debat sepse përndryshe nëse nuk ka debat dhe nuk ka komunikim të mirëfilltë.

Është mirë që çdo herë temat të diskutohen këtu në komitet për Komunitete sepse janë mbledhje zyrtare dhe diskutimet mbeten në procesverbal, çfarëdo qofshin ato.

Pastaj nuk kemi nevojë për lëvdata sepse e kemi për detyrë dhe detyrë e jona është të punojmë dhe të veprojmë andaj në bazë të komunikimeve dhe ngritjes së çështjeve të ndryshme ato normale që pastaj ngritën edhe tek instancat më të larta, prandaj kjo ishte ai shqetësimi im që e ceka sepse ne vazhdimisht qoftë në të kaluarën qoftë tani kemi qenë në komunikim me gjitha Drejtoritë në mënyrë që secili varësisht lëmisë të jap përgjigjet e veta, qoftë arsim, punësim, shëndetësi dhe gjitha dikasteret, prandaj e përsërisë që kjo është ajo çështja që e ngrisë çdo herë unë në raport me të drejtat e komuniteteve.

4. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, dëshiroj të ngris një shqetësim për një kërkesë projekt i cili është premtuar edhe më parë por që deri tani nuk është realizuar dhe ne tani nuk po dimë çfarë të bëjmë dhe k të kërkojmë më. Fjala është për ujësjellësin në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr."Ali Ajeti" ku gypat e ujit janë azbest dhe ai ujë nuk është i pijshëm dhe paraqet rrezik për pije. Banorët që jetojnë në atë lagje një numër i tyre kush i ka kushtet blejnë ujë të pijes por disa tjerë që nuk i kanë kushte e konsumojnë atë ujë, prandaj ne nuk po dim më cilit sektor t'i drejtohem, andaj kërkoj edhe nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që janë edhe pjesë e këtij Komiteti që ta kenë parasysh këtë problematikë.

Unë do të bëjë edhe një kërkesë zyrtare dhe të shohim pastaj ndoshta do të merret parasysh dhe do të ndërmerren veprime konkrete në funksion të realizimit të atij projekti për shtrirjen e ujësjellësit të ri në atë lagje.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, lidhur me çështjen e ngritur nga Kryesuesi i Komitetit, ju informoj dhe sqaroj se si projekt kah kohë të gjatë që është hartuar dhe i njëjti është dërguar edhe në Ministrinë përkatëse dhe madje edhe në Kryeministri ku në kuadër të kësaj është Zyra për Komunitete e cila na ka kërkuar 3 projekte dhe që është dërguar edhe ky projekt për ujësjellës i cili është i detajuar dhe ka një kosto rreth 39,000.00€ dhe që është hartuar në bashkëpunim mes Komunës së Podujevës dhe KRU ‘Prishtina’, do të thotë projekti është i gatshëm dhe për të kemi kërkuar financim, madje si projekt është i nënshkruar edhe nga Kryetari i Komunës i cili po ashtu është në dijeni të plotë dhe mund ta diskutojmë edhe në mbledhjen e radhës ku mund të jetë edhe drejtori i Shërbimeve Publike prezent dhe të na jap sqarime konkrete, mirëpo për të mos prituri kaq gjatë dhe të shpejtohet si proces kjo çështje të ngritet edhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Projekte të tilla më shumë janë të Kompanive publike apo Ndërmarrjeve publike siç është në rastin konkret KRU ‘Prishtina’ e cila nuk ka të bëjë me Komunën, mirëpo me ndihmën e Kryetarit të komunës sepse ne koordinojmë punët mes vete, të vihet deri te realizimi i projektit ngase si Kompani është fitimprurëse ashtu siç për rrymë e për shërbime tjera që ofrohen nga kompanitë e veçanta përkatëse publike, por ne jemi njerëz dhe duke ditur rëndësinë e realizimit të kësaj çështje dhe këtij projekti, është mirë që si çështje të ngritet edhe tek KRU ‘Prishtina’, edhe tek Kryetari i Komunës edhe tek Drejtoria e Shërbimeve Publike ngase mendoj se si projekt duhet të realizohet, por vetëm kërkohet angazhim.

Projektin e posedon edhe Kryesuesi i Komitetit për Komunitete sepse një kopje ja kam dhënë që ta ketë edhe ai për çdo rast.

z.Xhafer Ademi, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj shefin e ZKKK për informatat dhe sqarimet e dhëna, vërtetë për këtë problematik dhe realizim të projektit do të angazhohemi në vazhdimësi deri sa të realizohet.

Madje për këtë çështje mund ta ftojme në mbledhjen e radhës edhe drejtorin e DSHPMSH që të na informoj dhe të na jap sqarime lidhur me këtë projekt.

E vërtetë se projektin e posedoj dhe më ka hy në punë në disa raste sepse ka raste ku po kem edhe unë presion prej banorëve dhe po më duhet t’jua tregoj se projekti ekziston dhe ka shkuar në disa institucione e që vetëm pritjet të fillohet me realizimin e tij.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0016818/24
Podujevë, 06 mars 2024**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**